




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr.612/ 635 regjistri, datë 3.4.2014.
Nr.186 vendimi, datë 10.3.2015.



V E N D I M

NË

“EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata administrative e shkallës së parë Shkodër e përbërë nga :

Ahmet

JANGULLI

GJYQTAR

Asistuar prej sekretares Entela Hasmujaj, në Shkodër në datën 10.3.2015, shqyrtoi në seancë gjyqësore/ të hapur, çështjen administrative nr.612/ 635 akti, që u përket palëve :

Paditëse :

“K.A.N.” sh.p.k. e, identifikuar me Nipt in J66703078P, me seli Shkodër Shkodër SHKODËR E SHIROKËS. Përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. Adrian Kalamishi.

E përfaqësuar në gjykim nga përfaqësuesi ligjor z. Adrian Kalamishi/ i njohur me letërnjoftimin me nr.024628548 e me nr.personal G40118122B.

E paditur :

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.

Drejtoria e apelimit Tatimor pranë drejtorisë së përgjithshme të Tatimeve.

Objekti :

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftimit të vlerësimit për detyrimin tatimor me nr.prot 48/8 datë 20.5.2013 (pika 1-14) dhe i akteve të dala prej saj.
Detyrimin e të paditurit Dega Tatim Taksa Shkodër, për të paguar shpenzimet gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

B. Ligjore :

Neni 32 dhe 59, 246-280 i K.Pr.Civile. Ligji nr.49/2012, neni 15, 17, 21, 35, 40. Ligji nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar. Ligji nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ligji nr.8485 datë 12.5.199 K.P.AD.

neni 116, 117 i tij. ligji nr.10279 datë 20.5.2010. Ligji nr.8438. Ligji nr.9228. Ligji nr.7928. Ligji nr.9136. Ligji nr.9901 datë 14.2.2008, neni 12, dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të këtyre ligjeve.

Gjykata gjatë gjykimit, në prani të palës paditëse/ e cila hoqi dorë nga gjykimi, në mungesë të palëve të paditura/ e të avokaturës së shtetit, e si shqyrtoi aktet shkresore në tërësi.

V Ë R E N

I.

1. Se, pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesëpadi/ duke pretenduar sipas objektit.

1.1. padia është regjistruar *pa u paguar* shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

1.2. pala paditëse në kuadrin e plotësimit të të metave të padisë, nuk ka bërë ndryshime në elementët e padisë, **duke patur në gjykim në mënyrë përfundimtare** padinë e paraqitur për regjistrim si më sipër.

1.3. në *seancë*, palët e paditura nuk u paraqitën/ pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ndonëse kishin dijeni të rregullt, dhe në këto rrethana gjykimi u zhvillua në mungesë të tyre.

II. Rrethanat e faktit:

2. Palët me njeri tjetrin, janë në një konflikt, për veprimet administrative të kryera gjatë mbajtjes së aktit dhe gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ.

2.1. pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit të mësipërm, duke paraqitur para gjykatës/ **padinë e mësipërme** (bëhet fjalë për padinë e paraqitur për regjistrim), dhe duke mos i bashkëngjitur asaj/ asnjë lloj akti (akti administrativ, që është paraqitur, është në tre kopje, **në fotokopje**)

3. Çështja (padia) është paraqitur për gjykim në datën 3.4.2014. Në zbatim të ligjit procedural civil – administrativ/ gjykata ka vendosur që të regjistrohet padia e bashkë me regjistrimin të paguhet edhe taksa mbi aktet e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

4. Në datën 21.1.2015/ çështja ka kaluar për veprime përgatitore, duke thirrur edhe palët për t'i dëgjuar.

4.1. në *seancë*, pala paditëse nuk u paraqit/ pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ndonëse kishte dijeni të rregullt, dhe në këto rrethana gjykimi u zhvillua në mungesë të saj.

4.2. në veprimet përgatitore/ në seancën e datës 21.1.2015, kërkesëpadia i është kthyer palës paditëse për t'a plotësuar atë në elementët e saj të nevojshëm;

4.2.1. që kërkojnë nenet 154 e 156 të k.pr.civile, e konkretisht/ në lidhje me:

identifikimin e aktet identifikuese për palët ndërgjyqëse, adresën (vendbanimin ose vendqëndrimin) e palës paditëse, palës së paditur, dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ato, objektin, tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të drejtën mbi të cilën mbështetet kërkitimi, dhe kërkimin (me fjalë të tjera, duhen identifikuar palët ndërgjyqëse, duhet përcaktuar adresa (vendbanimi ose vendqëndrimi) i palëve, dhe i personave që përkatësisht i përfaqësojnë ato, duhet përcaktuar objekti, duhet orientuar kërkitimi, në mbështetje të shkakut ligjor, nëse jeni para këtij kërkitimi, para kësaj ndërgjyqësie në kuptimin procedural e material, mënyra e kërkitimit të së drejtës, duhet parashtruar fakti si për të drejtën tuaj ashtu dhe për të drejtën e shkelur nga ana e palës së paditur, dhe kërkimin e konkluduar), kopje të kërkesë padisë e të akteve provuese për të drejtën çfarë kërkohet, për palët e aktorët që marrin pjesë në çështje, dhe kur është paraqitur kërkesëpadia/ nuk janë paguar shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore;

dhe,

4.2.2. që kërkon neni 21 i ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", e konkretisht/ në lidhje me:

adresën e paditësit ose të përfaqësuesit, në të cilën duhet t'i dërgohen nga gjykata njoftimet dhe aktet, e një numër telefoni të tij ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, një adresë elektronike të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike;

sipas vendimit kthim për plotësim të datës 21.1.2015/ duke i lënë një afat kohor prej 3 ditësh, dhe për këtë arsye u ndërprejnë veprimet përgatitore (për më shumë p-v).

4.3. pala paditëse në kuadrin e plotësimit të të metave të padisë, ka paraqitur një akt, duke e trajtuar si/ "Plotësim i të metave të padisë", pa bërë ndryshime në elementët e padisë, por vetëm duke trajtuar se padia është në rregull, duke i bashkëngjitur asaj/ vetëm një njoftim për faljen e gjobës (tjetër akt, shkresa nr.161/1 prot datë 24.10.2014), dhe me kaq është mjaftuar me plotësimin e të metave të padisë, duke pretenduar vetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (për më tepër, aktet, në fashikull).

4.3.1. në rrethanat e mësipërme, nuk kishte më vend, për vazhdimin e veprimeve përgatitore, për të vazhduar me ndonjë veprim përgatitor.

4.3.2. mbi kërkesën e palës paditëse, duke u nisur nga parimet/ parimi i disponibilitetit, gjyqtari e vlerësoi se çështja duhej kaluar për gjyq/ edhe pse ishte në atë gjendje.

5. Në seancë/ në fazën e parashtrimt të kërtimeve dhe kërkesave për prova, pala paditëse/ hoqi dorë nga gjykimi i padisë.

III. Vlerësimi i gjykatës:

6. Në këto rrethana/ gjykata e çmon se, duhet vendosur pushimi i gjykimit të çështjes.

Sa sipër provohet me aktet shkresore dhe gjithë dokumentacioni në dosje.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 299 gërma b)/ për nenin 201 § 1 të k.pr.civile, dhe nenit 39 pika 3 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

VENDOSI

Pushimin e gjykimit në çështjen administrative nr.612/ 635 akti, datë 3.4.2014, që është ngritur nga pala paditëse "K.A.N." sh.p.k., për shkakun se hoqi dorë nga gjykimi.

Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen palës paditëse "K.A.N." sh.p.k..

Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë, në gjykatën administrative të apellit Tiranë.

U shpall në Shkodër me 10 mars 2015.

SEKRETARE
Entela HASMUJAJ

GJYQTAR
Ahmet JANGULLI

Shpenzimet gjyqësore:

Taks mbi akte

3'000 lekë

Njoftime

900 lekë

Akte – Letër

50 lekë

Shuma:

3'950 lekë

Sekretare
Entela HASMUJAJ

VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË. 25.03.2015

